



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Mbledhja nr. 44

Prishtinë, më 15mars2017, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, Salla S-II-

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Faton Topalli, Ali Sadriu, Hajdar Beqa, Abdyl Ymeri, Synavere Rysha, Naim Fetahu, Bali Muharremaj, Fikrim Damka dhe Enver Hoti.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj, koordinatorë e Komisionit, Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi dhe Mentor Hyseni, GIZ.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 01.03.2017;
3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për PVF-të e Ministrisë së Punëve të Brendshme, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, i ftuar z. Skender Hyseni, ministër;
4. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të performancës, Administrimi i programit për trajtim jashtë institucioneve shëndetësore publike, i ftuar z. Imet Rrahmani, ministër;
5. Të Ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi serendi i ditës u miratua mendryshime, ku u hoq nga rendi i ditës propozimi me amendamentet e Komisioneve të Përhershme sa i përket Projektligjit nr.05/L-122, për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 01.03.2017

Kryetari konstatoi se procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 01.03.2017, u miratua me ndryshime, sipas vërejtjeve të dhëna nga ana e deputetes Synavere Rysa.

3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për PVF-të e Ministrisë së Punëve të Brendshme, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

Faton Topalli, kryetar, tha se në këtë takim do të shqyrtohet Raporti i Auditimit për PVF-të e Ministrisë së Punëve të Brendshme, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, me këtë rast fjalënja kaloi deputetit, Bali Muharremaj, në cilësinë e raportuesit. Me këtë hapi diskutimin.

Bali Muharremaj theksoi se Opinioni i auditimit për PVF-të e MPB-së për vitin 2015 është Opinioni i pamodifikuar. Deri në fund të auditimit për vitin 2015, tri rekomandime janë implementuar, gjashtë janë adresuar pjesërisht, ndërsa dy nuk janë adresuar. Rekomandimet e pa adresuara ndërlidhen me mbulimin e pozitave me ushtrues detyre, si dhe me pagesën e të punësuarve nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve. Prokurimi si proces ishte realizuar në përputhje me rregullat e përcaktuar për prokurimin publik, më përjashtim të prokurimit për blerjen e pjesëve rezervë të automjeteve për të cilat kishin përdorë procedurat e kuotimit të çmimeve. Menaxhimi i pagave nuk ishte bërë në përputhje me Legjislacionin. Një numër i konsiderueshëm i pozitave menaxhohen përmes ushtruesve të detyrave. Pesë të punësuar ishin paguar më kontrata për shërbime të veçanta nga mallrat dhe shërbimet. Sfidë e MPB-së dhe Agjencive ishte edhe fusha e menaxhimit të pasurisë. Te Flota e Policisë një numër i konsiderueshëm i automjeteve presin për servisim. Dobësi janë identifikuar edhe në regjistrat e pasurisë (përfshirë regjistrat kontabël dhe regjistrat e pasurisë). Procesi i inventarizimit të Policisë së Kosovës nuk ishte përfunduar para përgatitjes së Pasqyrave Vjetore Financiare për të mundësuar identifikimin e mangësive në regjistrat e pasurisë. Dobësi kishte në identifikimin dhe menaxhimin e rrezikut, për të identifikuar pengesat e mundshme krahas përmbushjes së objektivave. Kjo reflekton mungesë të llogaridhënies të menaxhmenti i lartë lidhur me menaxhimin e regjistratit të rreziqeve. Për blerjen e pjesëve rezerve të automjeteve prokurimi ka përdorë procedurat e kuotimit të çmimeve, konkretisht për mirëmbajtjen dhe servisimin e automjeteve Policia e Kosovës kishte 19 kontrata aktive përmes procedurës së hapur të prokurimit (duke marrë parasysh shumëllojshmërinë e automjeteve). Mirëpo edhe përpos kësaj gjatë vitit 2015, kishte lidhur edhe 15 kontrata të tjera përmes procedurës së kuotimit të çmimit; Në tri raste janë identifikuar vonesa në realizimin e projekteve kapitale; Janë identifikuar vonesa në ekzekutimin e pagesave, konkretisht në pesë raste të testimeve, pagesat nuk janë realizuar brenda afatit ligjor; dhe procesimi i urdhërblërjeve pas pranimi të faturës, nga 41 pagesa/mostra të testuara, në 11 pagesa (tre në MPB, dy në IPK, tre në PK dhe tre në ASPK) kemi hasur në urdhër blerje të cilat janë procesuar pas pranimi të faturës. Menaxhimi i pagave

nuk ishte bërë në përputhje me legjislacionin. Një numër i konsiderueshëm i pozitave menaxhohen përmes ushtruesve të detyrave. Pesë të punësuar ishin paguar me kontrata për shërbime të veçanta nga mallrat dhe shërbimet. Dhënia e subvencioneve për personat e riatdhesuar nuk ishte monitoruar mjaftueshëm, sipas raporteve të monitorimit nga terreni lidhur me implementimin e planeve të biznesit dhe sipas raporteve nga Zyra e Departamentit për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar është vërejtur se nuk ishte monitoruar mjaftueshëm realizimi i tyre. Nga katër lëndët e testuara (secili në vlerë 2,000€), në një rast biznesi ishte në proces të themelimit, ndërsa në tri rastet e tjera bizneset nuk ishin funksionale. MPB dhe Policia e Kosovës, nuk kishin kontrole të mjaftueshme në raportimin e obligimeve. Në katër lëndë të testuara dy në MPB dhe dy në Policinë e Kosovës vërejtëm se nuk ishin raportuar si obligime të papaguar në baza mujore. Gjithashtu, në 13 lëndë të tjera të testuara vërejtëm se gjatë prezantimit të obligimeve nuk ishte bërë prerja e saktë e obligimeve.

Ali Sadri tha se është mirë që kemi një raport të pamodifikuar, dhe që nuk ka theksim të çështjes nga ana e auditorit. Poashtu tha se sipas raportit punët në MPB janë duke ecur mirë, por jo dhe në Policinë e Kosovës.

Enver Hoti tha se raporti ka evidentuar disa mangësi, për të cilat duhet dhënë përgjigje, siç janë pagesa e pagës në kundërshtim me vendimet e Qeverisë, mirëmbajtja jo e mirë e dosjeve të personelit dhe mangësi të tjera të evidentuara.

Hajdar Beqat theksoi se raporti ka shumëpërmirësime, sidomos nëfushën e Menaxhimit Financiar dhe të Kontrollit, ndërsa prej pikave më problematike, veçoi kontratat me kushtim të çmimit dhe kërkoi që procedurat të jenë të hapura nëkëtë aspekt, e jo të shkohet me kushte të çmimeve.

Faton Topalli, kryetar, tha se sa i përket pasqyrave financiare të MPB-së raporti është në rregull, mirëpo me problematike mbetet mosimplementimi i rekomandimeve të Auditorit, dhënë vitin paraprak.

Skender Hyseni, ministër në MPB, raportoi para Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike lidhur me raportin e Auditimit të vitit 2015, për këtë ministri, duke iu përgjigjur vërejtjeve të cilat i theksuan anëtarët e këtij Komisioni tha se gjendja në ministrinë që ai drejton, sa i përket zbatimit të rekomandimeve tani është më mirë, pasi që nga 17 rekomandimet e marra nga Auditori, 12 janë adresuar tashmë dhe 5 prej tyre janë në proces, bëhet fjalë për rekomandimet e dhëna nga raporti i auditimit për vitin 2015. Ndërsa tha se edhe sa i përket mbulimit të pozitave me ushtrues detyra gjendja është shumë më e mirë se në ministri e tjera. Gjithashtu dhe numri i të punësuarve, që janë paguar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, është tejet i vogël, krahasuar me vitet e mëhershme. Ai tha se që nga dita kur ka marrë përsipër ta udhëheqë Ministrinë e Punëve të Brendshme, ka vendosur një kornizë parimesh dhe se disiplina buxhetore ka qenë në fokus të tij.

Synavere Rysha lavdëroi punën e Ministrit të MPB-së dhe theksoi se është punuar shumë në adresimin e çështje të vlerësuara nga raporti i auditorit, në krahasim me vitet e kaluara raportit. Auditimit tregon se është bërë progres.

Përfundimi

KMFP, vendosi që Raporti i Auditimit për PVF-të e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), për vitin e përfunduar, më 31 dhjetor 2015, të mos adresohet për Seancë Plenare. MPB, të ndërmarrë veprime konkrete për adresimin rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

4. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të performancës, administrimi i programit për trajtim jashtë institucioneve shëndetësore publike.

Faton Topalli, kryetar, falënderoi ministrin për prezencën e tij, për të diskutuar për raportin e Auditimit dhe për administrimin e Programit për trajtimin jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike. Me këtë hapi diskutimin.

Abdyl Ymeri kërkoi nga ministri të dijë nëse rastet trajtohen në bazë të urgjencës, dhe se a ka ndërhyrje në raste të përzgjedhjes së pacientëve, poashtu theksoi se programi për trajtimin jashtë institucioneve shëndetësore publike është mirë të përmirësohet dhe të bëhen përpjekje më të mëdha të procedurave të aplikimit dhe të administrimit të programit si p.sh: të trajtimi jashtë vendit me urgjencë të lirohen nga obligimet e dokumenteve të shumta që duhen për trajtim.

Synave kërkoi që kërkesat e pacientëve të jenë të barabarta, dhe të mos të ketë keqpërdorime në këtë aspekt. Poashtu pati një propozim në këtë mbledhje, ajo tha se do të ishte më mirë që mjetet e ndara për pacientë jashtë institucioneve publike shëndetësore të shfrytëzohen në blerje të aparaturave. Poashtu theksoi që shuma për vitin 2015 ka qenë rreth 7.8 milionë euro, dhe për vitin 2014 janë 7.9 milionë euro. Janë 100 mijë euro më pak se në vitin 2015. Trajtimi jashtë institucioneve u adresohet atyre pacientëve të cilët nuk marrin shërbime brenda institucioneve dhe kushtet tona nuk i lejojnë ato mundësi. Prandaj janë një kategori e personave që ndihmohen dhe duhet pasur kujdes kur t'i trajtojmë. Mendoj që kjo shumë të zvogëlohet dhe të kemi mundësi për aparaturë më të mira më moderne dhe thjesht këto shërbime t'i marrin brenda institucioneve tona se një vlerë që është afër rreth 8 milionë euro të shkohet në blerje të aparaturave.

Ali Sadriu theksoi se në këtë raport mungon thelbi i trajtimit nga ana e auditorit, me këtë rast auditori është dashtë të paraqes në raport, nevojat e sakta për trajtimin jashtë institucioneve publike. Poashtu theksoi se ky proces ka filluar në vitin 2002, me një udhëzim administrativ tjetër që ndërkohë e kishin ndërruar dhe mund të themi që në atë udhëzim kishin lënë shumë çka që duhet me u shqyrtuar se ajo e ka hap derën edhe nuk është rastësi që tani i ke ato proceset e stentës. Kam parasysh kompetencat e Sekretarit të Përhershëm e keni lënë deri në 9 mijë euro ai vendos ai, pa e njoftuar ministrin fare. Unë nuk e di si e ka lejuar Ministria e Financave këtë udhëzim administrativ” tha z. Sadriu.

Naim Fetahi kërkoi nga Ministria e Shëndetësisë të bëjnë më shumë në Infrastrukturën Ligjore, sidomos në trajtimet si “infarkt”, për arsye se janë raste emergjente dhe çdo minutë që humbet pas dokumenteve, mund të kushtojë me jetë të pacientëve.

Fikrim Damkakërkoi nga Ministri i Shëndetësisë hapet një kardiologji në qytetin e Prizrenit, dhe nga ana e auditorëve kërkoi të tregohen harxhimet në kardiologji gjatë viteve 2014-2015.

Enver Hoti është interesuar të dijë arsyen pse ministria nuk informon pacientët të cilët kërkojnë mjete financiare, për mos aprovim të kërkesës së tyre.

Imet Rrahmani, ministër në MSH, duke iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve, tregoi se posa e ka marrë punën si ministër i ka filluar procedurat për ndryshimin e këtij udhëzimi administrativ. Ne iu kemi përveshur punën që ta përmirësojmë situatën në shfrytëzimin e këtij programi që është subvencionim i shërbimeve shëndetësore të cilat mund të ofrohen brenda institucioneve tona publike. E kemi bërë ndryshimin e Udhëzimit të parë, e kemi bërë plotësim ndryshimin e udhëzimit në fakt i cili në një periudhë të tillë të adresimit nuk ka mund me i analizuar të gjitha sfidat që janë paraqit më vonë edhe që kanë qenë në trashëgiminë edhe proceset më herët. Kemi kërkuar nga zyra e ministrit një auditim të brendshëm të procesit dhe i kemi evidentuar pothuajse këto parregullsi që i ka evidentua edhe Auditori. Për të cilat ne kemi marrë masa dhe vërehet se në vitin 2015-të ka pasur përmirësime dhe segmente ku ka pasur mundësi të përmirësohet aty për aty. Janë bërë ndryshime që sigurisht do të rrisin transparencën e shfrytëzimit të këtyre mjeteve sikurse që janë bërë ndryshime me një farë mënyre do të lehtësojnë format e aplikimit. Kemi vendosur edhe çmimet referente si shtojcë të Udhëzimit Administrativ.

Faton Topalli, kryetar, shprehu shqetësimet në raportin e performancës, i cili tha se është një raport i cili tregon mënyrën e përdorimit të këtij fondi. Puna që zhvillohet sipas auditorëve tregon mundësinë e keq përdorimit të mjeteve, po ashtu pengimin e ankesave të pacientëve të cilët nuk informohen për kërkesat e tyre. Dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit që ky raport të dërgohet në Kuvend.

Përfundimi

KMFP vendosi që Raporti i Auditimit të performancës, administrimi i programit për trajtim jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike, të mos adresohet për Seancë Plenare. Ministria e Shëndetësisë të bëjë ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ për Trajtim Shëndetësor të pacienteve jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore.

5. Të ndryshme

Faton Topalli, pasi që për këtë pikë nuk kishte diskutime, e mbylli takimin.

Takimi përfundoi në ora 13:15

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Faton Topalli